



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosova  
Komuna Drenasit  
Municipality Drenas  
Kuvendi i Komunës



02Nr. 060/04-34939 dt. 18/08/ 2026

Në bazë të nenit 40,43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), nenit 3 pika 3.7 si dhe nenit 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Drenasit

### Th ë r r e t

mbledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal, e cila do të mbahet më dt: 31.08.2026 e cila do të fillojë në orën 10:00.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës së Drenasit.

Për mbledhje propozohet ky

### Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Kuvendit Komunal i mbajtur me dt: 30.07.2026;
2. Propozim Vendim për miratimin e Draft Planit Komunal për Transportin Lokal në Komunën e Glllogocit për periudhën 2026–2031;
3. Propozim Vendim për themelimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës të Kuvendit të Komunës së Drenasit;
4. Propozim Vendim për Themelimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Drenasit;
5. Propozim Vendim për financim të projektit të Shoqatës së personave me Aftësi të kufizuara “HANDIKOS” ;
6. Propozim Vendim për shpalljen e Interesit të përgjithshëm Publik të parcelës nr.391-5 dhe pjesë e parcelës 381-1 ZK Drenas, për nevojat e Qendrës për punë sociale – Drenas;
7. Raport rreth korrje – shirjeve në territorin e Komunës së Drenasit për vitin 2026;
8. Pyetje dhe përgjigje;
9. Të ndryshme

Drenas, 18.08.2026



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Burim Bujupi



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-34592 dt. 17/08/ 2026

### PROCESVERBAL

I mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit, mbajtur më 30.07.2026. Mbledhja filloi në orën 10:00.

Mbledhjen e kryesoi **Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi**, i cili deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt. Në sallë ishin të pranishëm 25 anëtarë.

**Të pranishëm në mbledhje ishin: Kryesuesi i Kuvendit Burim Bujupi. Anëtarët e Kuvendit:** Ekrem Elshani (PDKRLL), Naim Gjeli (PDKRLL), Anjeza Kurtaj (PDKRLL), Selman Qallapeku (PDKRLL), Valdet Curri (PDKRLL), Gani Krasniqi (PDKRLL), Erblinë Morina (PDKRLL), Fitore Morina-Hoxha (PDKRLL), Edon Nishori (PDKRLL), Qëndresë Xhema (PDKRLL), Arigon Sinani (PDK), Jahir Hajdari (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Muhamet Xhemajlaj (PDK), Artian Krasniqi (PDK), Pajtime Berisha (PDK), Luljeta Elshani (PDK), Tringa Bujupi (PDK), Egzona Tërdevci (VV), Xhavit Drenori (GREEN), Arbër Halilaj (BD), Mchedin Salihu (Për Drenas e për Kosovë), Egzon Qorri (LDK), Liman Krasniqi (NISMA).

**Munguan:** Driton Ajazi (PDK) dhe Mërgim Pirraku (PDK).

**Të pranishëm ishin edhe:** Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, nënkryetari Arben Shala, stafi i Zyrës së Kryetarit dhe drejtorët e drejtorive komunale.

Mbledhja do të ketë këtë



## Rend dite:

1. Aprovimi i procesverbalit të mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), të dt. 29.06.2026;
2. Raporti i punës së Kryetarit dhe qeverisjes lokale për periudhën janar-qershor 2026;
3. Raporti financiar për periudhën janar-qershor 2026;
4. Të ndryshme.

Mbledhjen e kryesoi **kryesues i Kuvendit Burim Bujupi**, i cili hapi diskutimin rreth pikave të rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi** njoftoi se, në mbledhjen e KPF-së të gjitha pikat janë rekomanduar për shqyrtim në Kuvend. Ai shtoi se asambleistja Egzona Tërdevci ka kërkuar që në rend dite të shtohet edhe një pikë „Pyetje dhe përgjigje“ drejtuar drejtorëve të ekzekutivit.

**Xhavit Drenori** thëksoi se, ne nuk kemi qenë pjesë e mbledhjes së KPF-së për të ditur saktë se çfarë është kërkuar. Praktika e pyetjeve dhe përgjigjeve për drejtorët dhe ekzekutivin aplikohet edhe në komunat e tjera. Megjithatë, në këtë pjesë gjithmonë e kemi lënë të pika 'Të ndryshme', sepse aty kemi pasur mundësinë për të diskutuar. Mendoj se duhet të vendosim një rregull që kjo pikë të mos bëhet vetëm për konsum politik, por të ketë përmbajtje reale. Në këtë kontekst, do të ishte më mirë që pyetjet të dërgohen paraprakisht me shkrim. Kjo do t'u mundësonte drejtorëve të përgatisin përgjigje përmbajtësore, duke siguruar material për një debat të mirëfilltë dhe jo ad-hoc. Kjo formë na ndihmon të jemi më llogaridhënës, transparentë dhe përmbajtësorë. Kam përshtypjen se nëse këtë pikë e vendosim menjëherë pas aprovimit të procesverbalit, diskutimet mund të zgjasin pafundësisht nëse pyetjet nuk janë përgatitur paraprakisht me shkrim. Sidoqoftë, unë jam parimisht pro këtij propozimi.

**Kryesuesi Burim Bujupi** sqaroi se, kjo kërkesë do të përfshihet si pikë e rendit të ditës, por do të renditet si pika e parafundit, para pikës "Të ndryshme".

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci**, ndërhyri duke njoftuar se janë edhe tri akte që kanë ardhur nga MAPL-ja për rishqyrtim dhe propozimi për rishikimin e tyre duhet të bëhet tani nga asambleistët.

**Ekrem Elshani**, propozoi pikën shtesë përfshirje në rend të ditës. **Pika (1) Vendim për shfuqizimin e Vendimeve 02nr.462/01-11322, 02Nr.462/01-19805 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite pronat e paluajtshme të Komunës me procedurë të negocimit.**

**Valdet Curri**, propozoi pikën shtesë përfshirje në rend të ditës. **Pika (2) Për shfuqizimin e Vendimeve 02nr.462/01-11324, 02Nr.462/01-19811 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite pronat e paluajtshme të Komunës me procedurë të negocimit.**

**Erblinë Morina**, propozoi pikën shtesë. **Pika (3) Vendim për shfuqizimin e Vendimeve me nr. 02nr.462/01-11326 dhe 02Nr.462/01-19799, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (35 vite) të pronave të paluajtshme të Komunës me procedurë të negocimit.**



Pas prezantimit të këtyre pikave, **Egzona Tërdevci** kërkoi një pauzë të shkurtër prej 10 minutash, me qëllim që të sigurohet materiali më i detajuar për këto tri pika shtesë, duke qenë se nuk ishte e qartë se cilat vendime saktësisht po shfuqizoheshin.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci** tha se, nuk është e nevojshme të shkohet në pauzë, sepse bëhet fjalë për shfuqizimin e tri vendimeve për dhënien e pronës në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite. Ai sqaroi se ministria ka konstatuar që vendimet nuk janë në pajtim me ligjin për shkak të llogaritjeve. Komuna e ka shfuqizuar atë vendim në muajin maj, ndërsa tani ministria thotë se do ta dërgojë në Gjykatën Administrative sepse nuk është harmonizuar vendimi i marsit. Kryetari shtoi se Komuna e ka harmonizuar dhe shfuqizuar atë, prandaj i ftoi anëtarët ta votojnë këtë rend dite me këto tri pika. Ai siguroi se tani do t'i kenë edhe materialet, pasi është obligim ligjor nga ministria për t'i shfuqizuar vendimet, pavarësisht nëse ministria ka të drejtë apo jo.

**Xhavit Drenori** tha se, ka interes të dijë nëse këto shkresa kanë ardhur sot nga ministria apo ndonjë ditë më herët. Nëse kanë ardhur më herët, ato kanë mundur t'u përcillen anëtarëve me e-mail për të shikuar arsyeshmërinë, pasi aktualisht nuk ka material për të zhvilluar debat. Ai kërkoi që kjo të mbetet si vërejtje për të ardhmen, sepse kur kërkohet të shfuqizohet një vendim që është marrë nga vetë Kuvendi, anëtarët duhet ta dinë arsye. Prandaj, ai mendon se materialet duhet të sigurohen paraprakisht para se të fillojë debati, duke shtuar se e di që ajo që nuk është ligjore duhet të shfuqizohet, por duhet të ketë një arsyeshmëri.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci** tha se, nëse duan të bëjnë debat, mund të bëjnë, por aktet që kthehen për rishqyrtim duhet të shqyrtohen sepse ai nuk është i interesuar të humbë asnjë pikë në grantin e performancës. Prandaj, ai i ka sjellë vendimet për t'u shfuqizuar brenda afateve ligjore.

**Zeqir Hasi** tha se, edhe ai mendon që të shkohet në një pauzë prej 5 minuta dhe të sigurohet materiali i detajuar për secilin vendim, pasi as ata nuk janë të interesuar ta humbin grantin e performancës.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi** tha se, me kërkesën e znj. Tërdevci dhe z. Hasi, shkohet në pesë minuta pauzë.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, pas pauzës prej 5 minutash njoftoi se vazhdojnë me propozimin e parë për pikën shtesë që u kërkua nga znj. Tërdevci. "Pyetje dhe përgjigje për ekzekutivin", të cilën e hodhi në votim. Për votuan 23, kundër 0, abstenime 0. Pika futet si pikë e rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, e hodhi në votim pikën shtesë për përfshirje në rend të ditës. **Pika (1) Vendim për shfuqizimin e Vendimeve 02.nr.462/01-11322 dhe 02Nr.462/01-19805 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite të pronave të paluajtshme të Komunës me procedurë të negocimit.** Kjo pikë kaloi me 23 vota për, 0 kundër, 1 abstenim. Pika futet si pikë e rendit të ditës.



**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, e hodhi në votim pikën shtesë për përfshirje në rend të ditës. **Pika (2) Për shfuqizimin e Vendimeve 02.nr.462/01-11324 dhe 02.nr.462/01-19811 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite të pronave të paluajtshme të Komunës me procedurë të negocimit.** Kjo pikë kaloi me 23 vota për, 0 kundër dhe 1 abstenim. Pika futet si pikë e rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, e hodhi në votim pikën shtesë për përfshirje në rend të ditës. **Pika (3) Vendim për shfuqizimin e Vendimeve 02.nr.462/01-11326 dhe 02 nr.462/01-19799 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite të pronave të paluajtshme të Komunës me procedurë të negocimit.** Kjo pikë kaloi me 23 vota për, 0 kundër dhe 1 abstenim. Pika futet si pikë e rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi** tha se, pas miratimit të pikave shtesë nga anëtarët e kuvendit rendi i ditës mori këtë përbërje.

### **Rendi ditës:**

1. Procesverbal i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i dt. 29.06.2026;
2. Raporti i punës së Kryetarit dhe qeverisjes lokale për periudhën janar-qershor 2026;
3. Raporti financiar për periudhën janar-qershor 2026;
4. Vendim për shfuqizimin e Vendimeve 02nr.462/01-11322 dhe 02Nr.462/01-19805 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite të pronave të paluajtshme të Komunës me procedurë të negocimit;
5. Për shfuqizimin e Vendimeve 02nr.462/01-11324 dhe 02Nr.462/01-19811 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite të pronave të paluajtshme të Komunës me procedurë të negocimit;
6. Vendim për shfuqizimin e Vendimeve 02nr.462/01-11326 dhe 02Nr.462/01-19799 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite të pronave të paluajtshme të Komunës me procedurë të negocimit;
7. Pyetje dhe përgjigje për ekzekutivin;
8. Të ndryshme.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, hodhi në votim rendin e ditës, të cilit iu shtuan edhe propozim-vendimet e lartpërmendura. Të pranishëm në sallë ishin 25 asambleistë dhe rendi i ditës kaloi me 24 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës.

**Pika (1): Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kuvendit Komunal të dt. 29.06.2026.**

Pasi konstatoi se nuk ka diskutime nga anëtarët e Kuvendit, kryesuesi e hodhi në votim pikën e parë, 24 votuan për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës.

**Pika (2): Raporti i punës së Kryetarit dhe qeverisjes lokale janar-qershor 2026.**



**Xhavit Drenori** tha se, Raporti i punës së Kryetarit dhe qeverisjes lokale janar-qershor 2026 është një ndër dokumentet më të rëndësishme që harton komuna, ku ne, si përfaqësues të qytetarëve, ushtrojmë funksionin tonë të mbikëqyrjes mbi ekzekutivin. Roli ynë është t'i analizojmë ato, të kërkojmë sqarime aty ku ka paqartësi dhe të vlerësojmë nëse puna që është bërë u përgjigjet nevojave të qytetarëve. Administrata komunale e Drenasit tashmë ka fituar përvojë në përgatitjen e raporteve të tilla, ato zakonisht janë të strukturuar mirë dhe të hartuara me kujdes. Megjithatë, ne si asambleistë duhet të shikojmë përtej asaj që shkruhet në letër dhe t'i analizojmë me kujdes detajet, prandaj dua t'i falënderoj të gjithë ata që kanë kontribuar në përgatitjen e këtij raporti.

Por, unë jam ndalur te disa detaje ku qytetarët meritojnë sqarime, duke filluar nga faja nr. 8, te pikat 9 dhe 12 të raportit të Zyrës për Komunikim me Publikun. Do t'i sugjeroja Bekës që në të ardhmen të kenë një lloj mirëkuptimi, që edhe aktivitetet e anëtarëve të kuvendit që janë nëpër komisione të nxirren para publikut. Gjatë këtyre gjashtë muajve kemi krijuar disa trupa dhe kemi pasur aktivitete në disa komisione të anëtarëve të kuvendit, por të mos pasqyrohen edhe ato në ueb-faqen e komunës dhe në rrjetet e tjera sociale. Prandaj, le të mbetet si vërejtje që edhe puna e komisioneve të anëtarëve të kuvendit të përfshihet në këto raporte në të ardhmen.

Të Zyra Ligjore, në faqet 16 dhe 17, janë 98 seanca gjyqësore. Ne duhet të dimë se cilës natyrë i përket këto lëndë, për të pasur një pasqyrë se ku duhet të kemi kujdes në të ardhmen lidhur me vendimet tona, me qëllim që komuna jonë të ketë sa më pak punë me gjykatat kur është e paditur. Këtu mungon një qartësim shtesë, që ne si asambleistë të dimë më shumë se çfarë natyre janë këto seanca gjyqësore të komunës. Kjo është vërejtja e dytë.

Vërejtja e tretë është në faqen 26, të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme. Te faja 28, Zyra e Prokurimit, mungon një tabelë e mirëfilltë për të pasur mundësi të përcjellim se cilat projekte janë në radhë për t'u përfunduar; këtu ka më së paku informacione.

Në faqen 32, që lidhet me Kuvendin Komunal, këtu është definuar se sa mbledhje kemi mbajtur, por nuk ceket se sa aktivitete kanë pasur anëtarët e kuvendit nëpër komisione. Unë besoj që kjo punë nuk duhet të mbetet nën hije. Kishte qenë e udhës që edhe këtu të përshkruhej se Kuvendi Komunal, në gjashtëmujorin e parë të këtij viti, ka themeluar komisione të cilat janë aktive dhe po punojnë. Unë vullnetarisht marr pjesë në disa komisione duke dhënë kontribut me aq sa di dhe aq sa mundem.

Të faja 40, e DKA-së, shumica e lëndëve janë në proces kur është çështja të realizimi. Ne e dimë se vitet shkollorë zakonisht përfundojnë në gjashtëmujorin e parë, në qershor, prandaj është dashur të tregohet saktë se sa kanë qenë objektivat. Në faqen 44, suksesi i përgjithshëm është 93.44% me nota pozitive.

Të DSHPE, në faqen 51, të aktivitetet për Ditën Ndërkombëtare të Tokës dhe Mjedisit e të pastrimit, unë mendoj, drejtoreshë, që në të ardhmen duhet të na informoni edhe ne anëtarët e kuvendit përmes një emaili kur ka aktivitete të tilla. Në këtë mënyrë, edhe ne mund të dalim në mënyrë vullnetare, të heqim mbeturina dhe të sensibilizohet qëllimi final i këtyre aktiviteteve për ruajtjen e mjedisit. Ju duhet të na shihni neve si bashkëpunëtorë dhe miq, që ta bëjmë qeverisjen lokale edhe më të mirë.

Dhe e fundit, në faqen 58, të Drejtorisë e Infrastrukturës, i kam 10 pyetje rreth këtij raporti që është i padefinuar. Nuk pashë nëse janë arritur objektivat në gjashtëmujorin e parë në realizimin e projekteve që janë paraparë në terren dhe ku janë telashet, sepse me siguri ka edhe sfida, por ato mund të kalohen së bashku.



**Zeqir Hasi** tha se, sa i përket raportit, do të isha ndalur te auditimi, i cili flet më shumë për aktivitete por jo për gjetje. Nuk dihet se sa rekomandime janë dhënë gjithsej, sa janë zbatuar dhe sa kanë mbetur në proces për t'u zbatuar. Mungojnë edhe afatet e zbatimit të rekomandimeve, kush i monitoron ato rekomandime dhe deri kur duhet të zbatohen. Raporti është shumë përshkrues dhe nuk jep rezultate konkrete për auditimin.

Të Drejtoria për Infrastrukturë, të këto afatet, rruga 'Xhevë dhe Fehmi Lladrovci' e ka kaluar afatin 2-vjeçar.

Të raporti i DKA-së, potencohet në një vend menaxhimi i kontratave dhe evidentimi i gabimeve në bashkëpunim me NJMBNJ. Çfarë nënkuptoni me këtë 'evidentim të gabimeve'? A ka ndonjë kontratë që nuk është respektuar nga mësimdhënësit, apo ka mësimdhënëse që kanë marrë pagë dhe nuk kanë mbajtur mësim.

Pastaj, për konkursin dhe kuadrin arsimor sipas kërkesave të shkollave dhe pranimi të tyre, thuhet se është realizuar, bur kjo është e pavërtetë. Në Gjimnazin 'Gjergj Kastrioti Skënderbeu', që një vit zëvendësudrejtori ka dhënë dorëheqje dhe nuk është hapur konkursi për këtë pozitë. Pse nuk po shpallet që një vit, çfarë është në pyetje? Këto janë ato që dua t'i potencoj.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci**, falënderoi debatuesit lidhur me raportin dhe sqaroi se ky është Raporti i punës së Kryetarit dhe i qeverisjes lokale për periudhën janar-qershor, si dhe i zyrës së Kuvendit, por jo i vetë Kuvendit. Ai shtoi se raporti i Kuvendit është raport i veçantë, prandaj nuk kishte mundësi të përfshihej këtu. Sipas tij, janë munduar të bëjnë një raport përmbajtësor, por normalisht nuk janë realizuar të gjitha objektivat e parapara, pasi në këtë ka ndikuar mosformimi i qeverisë dhe buxheti që nuk ka qenë i miratuar. Po ashtu, ai potencoi se përmbaruesi po u merr mjete financiare dhe po u prish kodet buxhetore, gjë që reflekton edhe në punën e ekzekutivit.

Sa u përket rekomandimeve të auditorit, është fjala për auditorin e brendshëm që bën raport, rekomandime dhe takime, ku janë të përfshirë edhe tre anëtarë, ku njëri është prej asamblesë, dhe ata i vlerësojnë rekomandimet. Ne i zbatojmë atë që mundemi dhe sa kemi mundësi.

Lidhur me zëvendësudrejtorin, ai tha nuk e di a ka dhënë dorëheqje, nuk përzihem në atë pjesë. Ne kemi probleme me rekrutimin e stafit arsimor për shkak të ligjit të qeverisë për punësimet e atyre që e kanë përfunduar fakultetin në kolegjet private.

Si rezultat i kësaj, personeli ka marrë vendim mos t'i thërrasë ata, prandaj unë jam detyruar t'i shkruaj Ministrisë së Arsimit për të na konfirmuar nëse vlen udhëzimi apo ligji, dhe na është kthyer përgjigjja që vlen ligji.

Në fund, sa i përket rrugës 'Xhevë dhe Fehmi Lladrovci', nuk e di a kanë kaluar afatet. Ne mbajmë përgjegjësi për çdo gjë, por mund të ketë edhe arsye pse janë shtyrë. Është ta bëjmë infrastrukturën sa më të mirë të mundshme.

**Zeqir Hasi** tha se, sa i përket zëvendësudrejtorit, udhëzimi administrativ e thotë qartë se në rastet kur përfundimi i kontratës bëhet para kohe, konkursi shpallet 5 ditë pas marrjes së informimit zyrtar për përfundimin e kontratës. Kjo i ka ndodhur vitin e kaluar zëvendësudrejtorit që ka dhënë dorëheqje. Dhe për këtë çështjen e kolegjeve private, është mirë të sqarohet se çfarë do të ndodhë me gjithë këta të punësuar në arsim, që ta dinë nëse rrezikohen nëse janë punësuar jashtëligjshëm apo jo. Vetëm kaq.



**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci**, u përgjigj se kushdo që është i interesuar për komunikimet, mund t'i kërkojë ato përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare ose përmes postës elektronike (e-mail), dhe ekzekutivi do t'ia ofrojë ato çdokujt. Ai shtoi se mban përgjegjësi për ato që thotë, duke potencuar se çdo vendim që merret i ligjshëm, vazhdon të jetë i ligjshëm, dhe çdo vendim që merret i paligjshëm, mbetet i tillë. Sa i përket çështjes së zëvendës drejtorit, kryetari premtoi se do të japë përgjigje pasi të marrë informacionet e nevojshme nga drejtori përkatës.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, hapi diskutimin për pikën e tretë. **Pika (3): Raporti Financiar JANAR-QERSHOR 2026.**

**Egzona Tërdevci**, tha se i kam dy pyetje. Në faqen 3 janë shpenzimet e transportit, 74,532.70 €. A janë vetëm për transportin e nxënësve, apo përfshihet edhe diçka tjetër në atë kategori. Gjithashtu, në faqen 5, në katër vende, qiraja për prona publike është e rregulluar ndryshe: është kodi 50-408 dhe në një vend tjetër është shfrytëzimi i pronës publike 50-405. A bëhet fjalë për të njëjtën kategori të të hyrave, apo i keni ndarë në dy kode.

**Drejtori i Financave, Enver Hoxha** tha se, të shfrytëzimi i transportit është bartja e nxënësve në disa fshatra dhe bartja e fëmijëve me nevoja të veçanta. Te qiratë, qendra për banim social e ka kodin e veçantë për prona publike. Edhe te kultura e kemi një qirë ku bëjmë pagesa për fusha sportive sipas kërkesave të klubeve ose qytetarëve, si dhe te qiraja për pronën publike e kemi një kod tjetër, 407, ku janë pronat publike.

**Xhavit Drenori**, falënderoi për raportin dhe potencoi se ka nevojë për sqarime shtesë. Ai pyeti se pse në faqen 2 performanca e të hyrave shënon një rënie prej 11.77%. Sipas tij, është shumë mirë që në raport ekziston një krahasim, i cili ndihmon për të pasur një bazë krahasuese, mirëpo kërkoj sqarim nëse ky krahasim është vetëm për gjashtëmujorin apo për tremujorin e dytë të gjashtëmujorit të parë, duke kërkuar të dihet pse nuk është përfshirë periudha e plotë prej gjashtë muajsh.

Sa i përket performancës së shpenzimeve, ai vuri në dukje se është shënuar një rritje prej 15.42%. Ai shtoi se kur ka lëvizje kaq të mëdha, ekzekutivi duhet të tregojë se çfarë ka ndikuar në këtë rritje, në mënyrë që asambleistët ta kenë si informatë, duke kujtuar se ndonëse raporti nuk votohet, ai duhet të diskutohet.

Te shpenzimet operative, z. Drenori theksoi se rritja ka arritur në 25.64% në krahasim me vitet paraprake, andaj kërkoj të dihet se si ka ndodhur kjo te mallrat dhe shërbimet. Ai vuri në dukje se në shumicën e pikave haset shprehja për vendimet gjyqësore të kontratave kolektive, prandaj pyeti nëse rritja vjen vetëm prej tyre apo ka edhe vendime të tjera, duke shtuar se është në dijeni që përmbaruesi nuk kërkon miratim se nga cilat kode i tërheq mjetet. Ndërkaq, çështjen e transportit e konsideroi të sqaruar.

Në fund, lidhur me të hyrat vetanake në faqen nr. 4, ai kërkoj sqarim nëse raportimi është për gjashtëmujorin apo vetëm për tremujorin, duke shtuar se tatimi në pronë ka një tendencë rënieje. Po ashtu, ai përmendi se në faqen 4, te licencat për aktivitete individuale dhe profesionale, vërchet një rënie e madhe, me ç'rast shprehu interesimin për të ditur trendin e të bërit biznes në komunë.



**Drejtori i Financave, Enver Hoxha**, tha se, të shpenzimet prej 25.64%, këtu ka ndikuar rroga e 13-të, e cila është ekzekutuar në gjashtëmujorin e parë, plus vendimet gjyqësore në vlerë prej afër 700 mijë eurosh.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci**, shtoi se, shpenzimet gjyqësore për kontrata kolektive janë ato 700 mijë euro, por mund të kemi edhe shpenzime të tjera gjyqësore, mirëpo ato janë minore. Sepse, po të kishim më shumë, e humbim grantin e performancës.

**Drejtori i Financave, Enver Hoxha** th se, po vazhdoi në faqen dy, në rritjen prej 11.61% kanë ndikuar vendimet gjyqësore që janë ekzekutuar në vlerë prej 370 mijë e 834 eurosh.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci** tha se, të vendimet gjyqësore hyjnë edhe tiketat në komunikacion. Kësaj i ka kontribuar vendosja e stacionit të policisë në Komoran, përqindja më e madhe e shumës së tiketave vjen në Komunë.

**Drejtori i Financave, Enver Hoxha** tregoi se, në faqen nr. 4, te të hyrat vetanake janë gjobat nga inspektorati. Në vitin 2024 janë inkasuar 8 mijë e 524 euro, në vitin 2025 janë inkasuar 18 mijë euro, ndërsa në vitin 2026 ka pasur rënie. Te bizneset, edhe këtu ka rënie, por shkakët nuk i di.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, hapi për diskutim pikën e katërt të rendit të ditës. **Pika (4): Vendim për shfuqizimin e vendimeve 02nr.462/01-11322 dhe 02Nr.462/01-19805 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite të pronave të paluajtshme të Komunës me procedurë të negociimit.**

**Egzona Tërdevci** tha se, gjatë pauzës kërkonte të kemi një arsyetim nga MAPL-ja se pse po rrëzohen këto vendime. Këta numrat e vendimeve nuk janë të njëjtë me numrat e vendimeve të dt. 30 mars. Ne po shfuqizojmë vendimet e dt.30 mars, por numrat nuk po përputhen me vendimet me të cilat i kemi dhënë pronat në mars.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci**, sqaroi se ekzistojnë dy vendime për të njëjtën pronë. Ai njoftoi se më 30 mars prona është dhënë në shfrytëzim, mirëpo ministria e ka kthyer vendimin pasi nuk ka qenë në harmoni me ligjin për shkak të qarkullimeve bankare të kompanisë. Megjithatë, kompania ka dëshmuar se i ka mjetet në rregull, por ekzekutivi po i shfuqizon të dyja vendimet, meqë çdo vendim që shfuqizohet sot ka të bëjë me një parcelë. Në fund, kryetari kërkoi nga anëtarët e Kuvendit t'i shfuqizojnë këto dy vendime, pasi kjo përbën obligim ligjor, duke shtuar se megjithatë mbetet në vullnetin e tyre se si dëshironi të veprojnë.

**Egzona Tërdevci** shtoi se, unë nuk e kam problemin politik ashtu siç po e kthen ti, unë kam problem procedural. Ne kemi të drejtë ta kemi shkresën e MAPL-së dhe atë po kërkoj, të kemi shkresën e MAPL-së.

**Xhavit Drenori** tha se, nuk po e kontestojmë çështjen ligjore e as çështjen politike, por kjo është çështje procedurale. Pse unë, si anëtar i Kuvendit, nuk po informohem me kohë? Sot po kërkohet të shfuqizohet një vendim. Qëllimi im është që, kur të ngre dorën për të votuar, duhet të kem



informacione, e informacione nuk kemi. Tani me vonesë e kuptova që po i shfuqizojmë dy vendime, edhe të marsit, edhe të qershorit.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci**, u përgjigj, ne e kemi obligim t'i shfuqizojmë vendimet dhe kaq. Ju vendosni.

**Liman Krasniqi** tha se, unë do të kisha dëshirë të na sqaroni, a merr obligime Kuvendi Komunal në raport me kompanitë të cilave ua kemi dhënë pronat në shfrytëzim afatgjatë, pasi ne kemi marrë vendim për kompani konkrete dhe projekte konkrete.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci**, tha se, Komuna nuk merr asnjë obligim sepse ne nuk kemi lidhur kontratë. Kur të lidhim kontratën, atëherë marrim obligime. Merr obligim ministria, dhe ministria penalizohet. Unë po mundohem ta sqaroj, ju po thoni që po bëj politikë, por nuk po bëj politikë. Unë i kam sjellë me kohë, vetëm që të mos dëmtohem në garën për grantin e performancës.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, e hodhi në votim pikën e katërt.

**Pika (4). Për shfuqizimin e Vendimeve 02nr.462/01-11322 dhe 02Nr.462/01-19805 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite të pronave të paluajtshme të Komunës me procedurë të negocimit, të datave 30.03.2026 dhe 29.05.2026**

Për votuan 22 , kundër 0, abstenim 1.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, hapi për diskutim pikën e pestë të rendit të ditës.

**Pika (5): Për shfuqizimin e Vendimeve 02nr.462/01-11324 dhe 02Nr.462/01-19811 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite të pronave të paluajtshme të Komunës me procedurë të negocimit, të dt. 30.03.2026 dhe 29.05.2026**

Pasi nuk pati diskutime, pika u hodh në votim:

Për votuan 22, kundër 0, abstenim 1.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, hapi për diskutim pikën e gjashtë të rendit të ditës.

**Pika (6). Për shfuqizimin e Vendimeve 02nr.462/01-11326, 02Nr.462/01-19799 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite pronat e paluajtshme të Komunës me procedurë të negocimit, të dt.30.03.2026 dhe 29.05.2026.** Pasi nuk pati diskutime i hodhi ne votim. Për votuan 22, kundër 0, abstenim 1.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, hapi për diskutim pikën e shtatë të rendit të ditës.

**Pika(7). Pyetje dhe përgjigje për ekzekutivin.**

**Egzona Tërdevci** tha se, e kam një pyetje drejtorin e infrastrukturës behët fjalë për për projektin e rrugës laz Kodra e kam ngrit si qështje pra një ose dy seancave që kompania që i ka bër punimete ende ka garancion e rruga është e dëmtuar a keni ndërmarr veprime a kan fillu me riparuar rrugën.



**Xhavit Drenori** tha se, pari ne nuk e kemi ditur që kjo do të futej si pikë e rendit të ditës se vetëm ju antarëte kpl-së e paskit ditë ne jemi ardh të pa përgatitur qa patëm qeshtë për drejtor ishin në raport dhe u morrem vesh me i dërgu me shkrim,po e le me i shfrytëzu për me shkrim.

**Zeqir Hasi** tha se, ashtu siç e potencova edhe më herët, sot do t'ju pyesja për projektin e zgjerimit të rrugës 'Fehmi dhe Xhevë Lladrovci'. Kur përfundon, pse është vonuar dhe kush i merr përsipër dëmet e qytetarëve.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci**, sqaroi se lidhur me rrugën "Fehmi dhe Xhevë Lladrovci", e cila është në rindërtim, komuna ka mundësi të vendosë rrethojat dhe të mos e shfrytëzojë asnjë qytetar. Ai theksoi se kushdo që i ka dëmtuar gomat në një zonë ku shpejtësia e paraparë është 30–40 km/h, përgjegjësinë e merr vetë.

**Liman Krasniqi**, bëri një pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Urbanizmit, duke kërkuar të dijë nëse u jepen kushtet ndërtimore subjekteve përkatëse para se të fillojë hartimi i projekteve dhe marrja e lejes së ndërtimit për objektet banesore dhe ato afariste. Ai specifikoi rastin e pompave të benzinës që janë duke u ndërtuar në zonën e banimit, në një distancë prej 30–40 metrash nga objektet e banimit, si dhe për objektet e ndërtimit të lartë, të cilat në aspektin vizual dhe të kushteve tekniko-urbanistike duken shumë afër njëra-tjetrës.

**Mehedin Salihu** tha se, kjo pikë e rendit të ditës është e njëjtë me pikën "Të ndryshme". Ai falënderoi drejtorin e DSHPE-së (Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë) pasi ka filluar të përmirësohet furnizimi me ujë të pijshëm, por pyeti nëse ky përmirësim është i përkohshëm apo ka ndonjë rregullim më afatgjatë. Gjithashtu, ai kërkoi të dijë se çfarë po ndodh me urën e Shtrubulloves, çfarë përmban memorandumi dhe ku ka mbetur lënda.

**Xhavit Drenori**, shprehu të njëjtin shqetësim që kanë ngritur qytetarët, duke pyetur se deri ku ka shkuar puna me realizimin e projektit të urës që të çon te fshati Shtrubullovi dhe fshatrat e tjerë.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci**, sqaroi se sa i përket zhvillimit të projektit të urës, tre përfaqësues kanë qenë në takim me ministrin. Ai shtoi se ka mbetur të bëhet alokimi i mjeteve dhe pastaj ministria t'u kthejë një përgjigje. Ai theksoi se ministria u ka dhënë të drejtën për të zhvilluar procedurat e prokurimit, megjithatë ai i ka kërkuar ministrit që t'i zhvillojë vetë këto procedura. Kryetari shtoi se këto dy çështje akoma nuk janë të sigurta, por beson se do të sigurohen së shpejti. Sipas tij, kjo është një gjë e mirë pasi kështu ruhet buxheti i komunës dhe projekti realizohet me buxhet të nivelit qendror.

**Drejtori i Urbanizmit, Petrit Gashi**, tha se sa i përket pyetjes së z. Krasniqit, të gjitha këto janë të përcaktuara me harta zonale dhe plane rregulluese. Ai theksoi se natyrisht e informojnë secilin dhe sqaroi se sa u përket pompave të benzinës, në dy vjetët e fundit nuk kanë pasur asnjë kërkesë të re në asnjë aks rrugor. Ai shtoi se sipas hartave zonale, rrugët kryesore jashtë komostacionit, në një gjerësi prej 200 metrash në të dyja anët e rrugës, janë zonë ndërtimore për shërbime tregtare, gjë që nuk e ndalon kërkesën për pompa të derivateve dhe se nuk ka pasur ndalesa të tilla deri më tani.



**Liman Krasniqi** tha se, sa u përket hartave zonale, është e qartë që aty paraqiten të gjitha kushtet dhe se çdo komunë paraprakisht i lëshon kushtet urbane. Megjithatë, ai theksoi se nuk duhet t'i jepet mundësia çdo kompanie që në bazë të hartave zonale të vendosë vetë, pasi po shihet kaosi që po krijohet me ndërtimet, siç është rasti përballë hekurudhës dhe distanca mes objekteve. Ai shtoi se edhe te pompat e benzinës, pavarësisht se ekziston një vendim për distancën në metra, nuk lejohet që ato të ndërtohen në rrugë që në të ardhmen do të kenë kuptimin e një autostrade. Ai përfundoi duke thënë se pompat po lejohen në një distancë prej 20–40 metrash nga objektet e banimit dhe shprehu dyshime se ku janë lexuar ato ligje kur bëhet fjalë për rrezikimin e jetës së banorëve, pavarësisht thirrjes në disa nene ligjore.

**Drejtori i Urbanizmit, Petrit Gashi**, theksoi edhe një herë se në ato komuna ku ka harta zonale, palët informohen për të drejtat e tyre. Ai sqaroi se kushtet sa i përket pompave të benzinës dhe ndërtimeve afër autostradave ose rrugëve nacionale nuk përcaktohen nga komuna, por nga ministria përkatëse. Nëse ministria vlerëson se gjithçka është në rregull, atëherë komuna nuk ka të drejtë t'i refuzojë ato dhe në ditën që sillet dokumentacioni i kompletuar, pala pajiset me leje ndërtimore.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci**, shtoi se komuna nuk u jep leje pompave të benzinës pa i marrë më parë të gjitha pëlqimet nga niveli qendror, dhe nëse pëlqimet merren, komuna është e detyruar t'ua japë lejen.

**Liman Krasniqi** tha se, sa u përket kushteve ndërtimore, zyrtarët janë të obliguar që nga çdo kompani që kërkon leje ndërtimi, fillimisht të kërkojnë plotësimin e kushteve ndërtimore në bazë të kriterëve, pasi aktualisht nuk ka plan rregullues dhe plan detal, dhe ashtu veprojnë edhe komunat e tjera.

**Mehedin Salihu**, pyeti edhe një herë nëse ky përmirësim i furnizimit me ujë është vetëm sa për sy e faqe para mbledhjes, apo ka vërtet diçka pozitive dhe afatgjatë.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci**, sqaroi se nuk ka ndonjë përmirësim të menjëhershëm pasi pompat në Bivolak ende nuk janë vendosur, por shtoi se zgjidhja më e mirë është zhvillimi i procedurave për liqenin e Vërbocit.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, hapi për diskutim pikën e tetë të rendit të ditës. "Të ndryshme".

**Arbër Halilaj**, u ndërlidh me këtë pikë duke paraqitur një propozim që e kishte bërë shumë më herët, që në një nga seancat e radhës në muajin gusht të diskutoret për Statutin e Komunës dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit. Ai vuri në dukje se këto dokumente janë të zbehta, datojnë që nga viti 2008 dhe kanë nevojë për amendamentim dhe plotësim. Gjithashtu, ai u shpreh i gatshëm të japë kontributin e tij në ndonjë komision që mund të formohet për këtë qëllim.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci**, theksoi se shqetësimi i z. Halilajt është me vend dhe se duhet të formohet një komision. Megjithatë, ai ua kujtoi të pranishmëve se edhe më parë ishte formuar një komision për ndryshimin e statutit, por në momentin që ai ndryshohet, nuk mund të



përdoret emërtimi "Drenas", por duhet të mbetet "Glllogoc". Ai sqaroi se në të kundërtën nuk mund të merret ligjshmëria nga MAPL-ja (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal), pasi ata e kthejnë mbrapsht me arsyetimin se është në kundërshtim me ligjin.

**Edon Nishori** tha se, është shumë e rëndësishme dhe jetike për qytetarët e Komoranit që të bëhet një zgjidhje për rrethin e Komoranit, i cili ka një qarkullim shumë të madh dhe është totalisht i bllokuar. Ai pyeti nëse komuna, si institucion, mund të bëjë një kërkesë zyrtare për të gjetur një zgjidhje apo të paktën të sugjerojë vendosjen e disa semaforëve.

**Drejtori i Infrastrukturës, Endrit Gllareva**, sqaroi se në takimin me ministrin i është premtuar se është duke u hartuar projekti për rrugën Komoran–Caralevë, duke përfshirë rrethin dhe rehabilitimin e rrugës. Ai shtoi se drejtorja e tij ka bërë kërkesa të vazhdueshme për këtë çështje.

**Egzona Tërdevci** tha se, Endriti sapo dha përgjigjen dhe se ajo e kishte informuar edhe Edonin para seancës. Ajo theksoi se ministria aktualisht nuk ka kontratë për katër korsi pasi projekti është në fazën e tenderimit. Ajo sqaroi se kjo është një fazë procedurale ku për momentin nuk mund të bëhet asgjë, por në të ardhmen do të bëhet një zgjidhje, ndonëse nuk dihet saktësisht se sa kohë do të marrë.

**Tringa Bujupi**, ngriti disa pyetje që i ishin adresuar nga banorët e fshatit Arllat. Ajo theksoi se poshtë **Lagjes së Xhamisë** ndodhet një pjesë e banuar ku banorët kanë shprehur shqetësimin se ende nuk kanë ndriçim publik. Po ashtu, sipas tyre, kanalizimi i ujërave të zeza nuk është zgjidhur ende dhe ata përballen me mungesë të ujit të pijshëm. Gjithashtu, ajo përcolli kërkesën e qytetarëve për shtrimin e disa rrugëve në fshatin Arllat, konkretisht për rrugën "Hel Bujupi" dhe rrugën "Fan Noli", si dhe për dy rrugë të tjera të pashtuara që ende nuk kanë emërtim zyrtar. Ajo kërkoi që këto çështje të trajtohen me prioritet dhe të gjendet një zgjidhje.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci**, theksoi se banorët e **Lagjes së Xhamisë** duhet të marrin pjesë në dëgjimet publike për t'i parashtruar kërkesat e tyre dhe për të diskutuar. Ai shtoi se ata duhet të vijnë edhe kur raportohet për periudhën gjashtëmujore. Kryetari pranoi se janë në dijeni për problemet që ekzistojnë në atë **Lagje**, por potencoi se kanë ndërmarrë veprime të shumta atje dhe se projekti për ndriçimin publik është në proces e sipër.

**Liman Krasniqi** theksoi se, për të zgjidhur problemin e kolonave dhe pengesave pranë Qendrës së Mjekësisë Familjare në Komoran, të analizohet qasja e objektit afarist që ndodhet në një distancë shumë të shkurtër nga udhëkryqi. Ai kërkoi që kjo qasje të analizohet në bazë të normave dhe projektimit, dhe t'i sugjerohet pronarit që ta heqë qasjen aktuale në distancë prej 7–8 metrash dhe ta zhvendosë atë në anën e kundërt të parkingut. Ai theksoi se, në bazë të rregullave teknike, ligjërisht nuk lejohet kyçja e një objekti afarist në një distancë kaq të shkurtër nga udhëkryqi, prandaj komuna ka mundësi të intervenojë në këtë rast për ta liruuar sado pak atë udhëkryq.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci**, u përgjigj se nuk e dinte saktësisht se për cilin objekt afarist bëhej fjalë, por sqaroi se çdo objekt e ka qasjen aty ku ka kërkuar dhe ka marrë pëlqimin nga ministria. Ai shtoi se aktualisht është duke ndërtuar një rrugë përgjatë hekurudhës pikërisht



për t'u ikur kyçjeve ilegale në rrugën kryesore. Ai vuri në dukje se i kanë bërë kërkesë ministrisë disa herë, por ende nuk kanë kthyer përgjigje, dhe pa marrë një përgjigje nga niveli qendror, komuna nuk mund të ndërmarrë asgjë.

**Liman Krasniqi** tha se, sa u përket lejeve që jep Ministria e Infrastrukturës, Drejtoria e Urbanizmit duhet të ketë parasysh se ministria jep vetëm pëlqimin që një subjekt afarist ka të drejtë të kyçet në rrugën regjionale, ndërsa distancën nga udhëkryqi e përcakton vetë komuna përmes kushteve urbanistike.

**Xhavit Drenori**, shprehu pakënaqësinë e tij me përgjigjen që kryetari i dha koleges Tringa Bujupi, e cila ngriti një çështje në emër të banorëve të fshatit Arllat. Ai theksoi se një nga detyrat e anëtarëve të kuvendit është që t'i ngrenë shqetësimet e qytetarëve që i kanë deleguar aty. Gjithashtu, ai iu drejtua kryesuesit me kërkesën për t'i mbrojtur anëtarët e kuvendit në të drejtën e tyre elementare për të ngritur çështje dhe për të kërkuar përgjigje nga ekzekutivi. Ai shtoi se është çështje e ekzekutivit nëse dëshiron të kthejë përgjigje, por nuk duhet të lejojë që anëtarët të nënçmohen me deklaratat që u kërkojnë banorëve të vijnë vetë në mbledhje.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovi** nuk debatova me tringën se është re nuk i din krejt temat që i diskutojmë për qdo vjet nuk i thashë atyre me ardh në komunë në dëgjime publike po nëpër lokalitete në këtë rast në Arllat,kanalizimin dy herë e kanë penguar vet banoret dhe kur e shpallim tenderin banoret pengojnë pastaj kryhet kontratat dhe kur shpallet tenderi pengohet puna kontrata përfundon dhe humb buxheti, problemi i dytë është rruga "Fan Noli" është pronë private dhe në nuk mundemi me shtrë derisa të kthejnë të bëjnë pronë publike pastaj mundemi me ja shtrë kurse për lagjen foniqi që ende nuk ka ndriqim publik e thash edhe me herët jemi në proces e sipër.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, iu drejtua zotëri Drenorit duke thënë se ai e ka mbrojtur zënj. Bujupi në heshtje. Ai shtoi se "**Lagja e Xhamisë**" është e përfunduar tërësisht me ndriçim, ndërsa rruga "**Fan Noli**" mbetet private, duke përfunduar se ndonjëherë edhe heshtja shërben si mbrojtje ndaj kolegëve.

**Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, pasi konstatoi se nuk kishte diskutime të tjera, e shpalli të mbyllur mbledhjen.

*Mbledhja përfundoi në orën 12:15.*

**Proccsmbajtësja: Fakete Hoti**

**Lekturoi: Nikelinda Bujupi**



**Kryesuesi i Kuvendit**

**Burim Bujupi**





**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
**Komuna e Drenasit**  
Zyra e Kryetarit



01 Nr. 400/01 - 33131 dt. 10/08/ 2026

Në mbështetje të nenit 58, paragrafi 1, nënparagrafi h, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72, pika h, të Statutit të Komunës së Drenasit, si dhe nenit 6 paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor, me propozim të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, Kryetari i Komunës paraqet këtë:

**PROPOZIM - VENDIM**

**Për miratimin e Draft Planit Komunal për Transportin Lokal në Komunën e Glogocit për periudhën 2026–2031.**

**Neni 1**

I propozohet Kuvendit të Komunës së Drenasit miratimi i Draft-Planit Komunal për Transportin Lokal në Komunën e Glogocit për periudhën 2026–2031.

**Neni 2**

Draft-Plani Komunal për Transportin Lokal në Komunën e Glogocit është hartuar nga Komisioni i emëruar me Vendimin e Kryetarit të Komunës, Nr. 01-400/01-9519, të datës 13.03.2026. Plani është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe pasi ka kaluar procedurat e dëgjimit publik te parapara me ligj, dhe i paraqitet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi janë përgjegjës Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.

**Neni 4**

Ky Propozim-vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Glogocit dhe pas përfundimit të procedurës së kontrollit të ligjshmërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.



Kryetari i Komunës:

*Ramiz Lladrovci*  
Ramiz Lladrovci



## ARSYETIM

Me përfundimin e periudhës së vlefshmërisë së Planit Komunal për Transportin Lokal në Komunën e Glllogocit, si dhe në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, konkretisht me nenin 6, paragrafin 2, të Ligjit Nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor, është paraqitur nevoja për hartimin dhe miratimin e një plani të ri.

Qëllimi i këtij Propozim-Vendimi është miratimi i Planit Komunal për Transportin Lokal të Udhëtarëve (PKTL) në Komunën e Glllogocit, si dokument strategjik dhe planifikues për organizimin, zhvillimin dhe menaxhimin e transportit publik të udhëtarëve në territorin e Komunës.

Miratimi i këtij Plan synon krijimin e një sistemi të qëndrueshëm, efikas dhe të sigurt të transportit publik urbano-periferik, rritjen e mbulueshmërisë së rrjetit të transportit, përmirësimin e qasjes së qytetarëve në shërbimet publike, si dhe ngritjen e cilësisë, sigurisë dhe besueshmërisë së shërbimeve të transportit.

Nëpërmjet zbatimit të PKTL-së, Komuna synon të harmonizojë planifikimin lokal me politikat kombëtare në fushën e transportit, të përmirësojë m

obilitetin e qytetarëve dhe të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social të Komunës.





**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
**Komuna e Drenasit**  
Zyra e Kryetarit



01 Nr 400/01- 33532 dt. 11/08/2026

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1, nën paragrafi h i Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 11, 12, 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"), nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit dhe nenit 22 të Rregullores për punën e Kuvendit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e ardhshme të aprovoi këtë:

**Propozim Vendi**

**Për themelimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Drenasit.**

**Neni 1**

Më këtë Propozim Vendi i propozohet Kuvendit të Komunës themelimi i komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Drenasit në këtë përbërje:

1. \_\_\_\_\_ -Kryesues;
2. \_\_\_\_\_ -Anëtarë;
3. \_\_\_\_\_ -Anëtarë;
4. \_\_\_\_\_ -Anëtarë;
5. \_\_\_\_\_ -Anëtarë;

**Neni 2**

Komisioni për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Drenasit ka për detyrë të shqyrtojë Rregulloren aktuale të Punës së Kuvendit të Komunës së Drenasit, të identifikojë dispozitat të cilat kanë nevojë për ndryshim dhe/ose plotësim, të propozojë ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme në përputhje me legjislacionin në fuqi, të bashkëpunojë me Kryesuesin e Kuvendit, anëtarët e Kuvendit dhe strukturat përkatëse të Komunës gjatë hartimit të ndryshimeve dhe plotësimeve, të përgatisë Draft-Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Punës së Kuvendit dhe ta procedojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Komunës së Drenasit.

**Neni 3**



Mandati i Komisionit fillon nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi dhe përfundon me përmbushjen e detyrave të përcaktuara me këtë Vendim.

#### **Neni 4**

Komisioni, pas përfundimit të punës, i paraqet Kryesuesit të Kuvendit të Komunës dhe Kuvendit të Komunës draftin për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Drenasit, së bashku me arsyetimin përkatës.

#### **Neni 5**

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.

  
Kryetari i Komunës  
Ramiz Lladrovci

#### **ARSYETIM**

Komuna e Drenasit me qëllim të harmonizimit dhe përmirësimit të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Drenasit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nevojat e funksionimit të Kuvendit, Kryetari i Komunës përmes këtij propozim vendimi i propozon Kuvendit të Komunës themelimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e saj.

Komisioni do të shqyrtojë dispozitat ekzistuese dhe do të përgatisë propozimet përkatëse për ndryshime dhe plotësime, të cilat do të procedojë për shqyrtim dhe miratim nga organet kompetente si dhe synon që procesi i ndryshimit dhe plotësimit të Rregullores së Punës së Kuvendit të realizohet në mënyrë profesionale, gjithëpërfshirëse dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nevojat e funksionimit të Kuvendit të Komunës së Drenasit, andaj për këtë arsye, propozohet miratimi i këtij propozim vendimi.





**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
**Komuna e Drenasit**  
Zyra e Kryetarit



01 Nr 400/01-33536 dt. 11/08/2026

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1, nën paragrafi h i Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 11, 12, 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"), nenit 8 dhe nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e ardhshme të aprovoi këtë:

**Propozim Vendim**

**Për Themelimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Drenasit.**

**Neni 1**

Më këtë Propozim Vendim i propozohet Kuvendit të Komunës themelimi i komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Drenasit në këtë përbërje:

1. \_\_\_\_\_ -Kryesues;
2. \_\_\_\_\_ -Anëtarë;
3. \_\_\_\_\_ -Anëtarë;
4. \_\_\_\_\_ -Anëtarë;
5. \_\_\_\_\_ -Anëtarë;

**Neni 2**

Komisioni për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Drenasit ka për detyrë që të shqyrtojë Statutin aktual të Komunës së Drenasit, të identifikojë dispozitat të cilat kanë nevojë për ndryshimin dhe/ose plotësim, të propozojë ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme në përputhje me legjislacionin në fuqi, të bashkëpunojë me strukturat dhe njësitë përkatëse të Komunës gjatë hartimit të ndryshimeve dhe plotësimeve, si dhe të përgatisë draft-statutin për ndryshimin dhe/ose ndryshimin e Statutit të Komunës dhe ta procedojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Komunës së Drenasit.

**Neni 3**

Mandati i Komisionit fillon nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi dhe përfundon me përmbushjen e detyrave të përcaktuara me këtë Vendim.

**Neni 4**



Komisioni, pas përfundimit të punës, i paraqet Kryesuesit të Kuvendit të Komunës dhe Kuvendit të Komunës draftin për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit, së bashku me arsytimin përkatës.

#### **Neni 5**

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.



Kryetari i Komunës  
Ramiz Lladrovci

#### **ARSYETIM**

Komuna e Drenasit me qëllim të shqyrtimit dhe harmonizimit të Statutit të Komunës së Drenasit me legjislacionin në fuqi dhe nevojat e funksionimit të Komunës, Kryetari i Komunës përmes këtij propozim vendimi i propozon Kuvendit të Komunës themelimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit.

Komisioni do të shqyrtojë dispozitat ekzistuese dhe do të përgatisë propozimet përkatëse për ndryshime dhe plotësime, të cilat do të procedojë për shqyrtim dhe miratim nga organet kompetente, andaj për këtë arsye, propozohet miratimi i këtij propozim vendimi.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna Drenas (Glllogocit)  
Kuvendi Komunal



01- Nr 400/01-34682 dt. 18/05/2026

Në veshtrim të nenit 58, paragrafi 1, nën-paragrafi h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 34, pika 6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores 12 Nr. 320-19332 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, Rregullores MF-NR 04/2017 mbi Kritret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, dhe Rregulloren 02-400/01-18380 për Ndryshim dhe Plotësim të Rregullores për Ndarjen e subvencioneve, vendimit 01 Nr 020/04-17991, të dt. 19.05.2026, si dhe buxhetit të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2026, me propozim të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale, Kryetari i Komunës paraqet këtë:

## **PROPOZIM VENDIM PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT**

### **Neni 1**

Me këtë propozim vendim, kërkohet mbështetja financiare për projektin **“Intervenimi në fëmijërinë e herëshme, përmes ofrimit të shërbimeve sociale dhe rehabilituese për fëmijët me kufizime fizike dhe të kombinuara”**, të Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara “Handikos”, lidhur me mbulimin e shpenzimeve për zhvillimin e aktiviteteve për vitin 2026.

### **Neni 2**

Projekti i Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara “HANDIKOS”- Intervenimi në fëmijërinë e herëshme, përmes ofrimit të shërbimeve sociale dhe rehabilituese për fëmijët me kufizime fizike dhe të kombinuara, përkrahet në shumën prej 5.000 € (pesë mijë euro), mjete të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve për vitin 2026.

### **Neni 3**

Financimi - Subvencionimi i projektit do të bëhet nga kategoria ekonomike e shpenzimeve subvencione dhe transfere të parapara me Buxhetin e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale.

### **Neni 4**

Mjetet financiare barten në konton e Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara “HANDIKOS”, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale është e obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2 të këtij propozimvendimi të përcjellë implementimin e projektit, duke kërkuar nga OJQ “HANDIKOS”, që të bëjë raport narrativ-me shkrim dhe financiar përmes zyrtarit monitorues në mënyrë që të njoftojë DSHMS-në për mënyrën e shpenzimit të mjeteve.

### **Neni 5**

Ky propozim vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit Komunal të Drenasit dhe vlerësimi të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së, për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale.

**KRYETARI I KOMUNËS**  
  
**Ramiz Lladrovci**





### **Arsyetimi**

Bazuar në nenin 16 paragrafi 3, të Rregullorës MF-NR. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Rregullores Nr. 12/320-19338, të dt. 07.04.2017 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, është formuar komisioni me Vendimin 01 Nr 020/04-17991, të dt. 19.05.2026, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve përmes thirrjes publike Nr. 01-400/01-17062 dt. 12.05.2026, të shpallur nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2026.

Komisioni ka shqyrtuar dhe vlerësuar aplikacionet e aplikantëve për subvencionim të OJQ-ve në bazë të thirrjes publike të lartëcekur, ku gjithsej kishin aplikuar dy (2) OJQ.

Meqë vlera e përkrahjes financiare në bazë të thirrjes publike është 5.000 €, kjo shumë do t'i ndahet OJQ-së që i ka plotësuar kriteret, financimi- subvencionimi i projektit do të bëhet nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere të parapara me Buxhetin e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Komisioni i caktuar nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, gjatë zhvillimit të procedurës së ndarjes së subvencionit, nuk ka përgatitur propozim-vendim për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Komunës, pasi në Rregulloren MF-Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, si dhe në aktet përkatëse që rregullojnë këtë procedurë, nuk është përcaktuar në mënyrë të shprehur obligimi që vendimi për ndarjen e subvencionit pas përfundimit të procesit të vlerësimit nga Komisioni, të propozohet për miratim në Kuvendin e Komunës. Megjithatë, gjatë procedurës së realizimit të pagesës, lënda është kthyer nga procedura e pagesës, me arsyetimin se për realizimin e pagesës kërkohet vendim i miratuar nga Kuvendi i Komunës. Për këtë arsye, me qëllim të përfundimit të procedurës administrative dhe mundësimit të realizimit të pagesës për përfituesin e përcaktuar nga Komisioni, Drejtoria është e detyruar që çështjen ta procedojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Komunës.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Komuna e Drenasit**  
**Zyra e Kryetarit**



Nr 01-400/01-34729 dt. 12/08/2026

Në bazë të nenit 58, pika h, neni 17, pika k, i Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72.2 pika a të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 pika d të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"), Ligjit Nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare si dhe kërkesës nga Udhëheqësja e Qendrës për Punë Sociale e dt:18.08.2026, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e ardhshme të aprovoi këtë:

**Propozim Vendim**

**Për shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të parcelës nr. 391-5 dhe pjesë e parcelës 381-1 ZK Drenas, për nevojat e Qendrës për Punë Sociale-Drenas.**

**Neni 1**

**Të MIRATOHET** Propozim -Vendim që të shpallet me interes të përgjithshëm ngastra kadastrale 391-5 dhe pjesë e ngastrës 381-1 ZK Drenas, dhe të njëjtat do të shfrytëzohen për nevoja të Qendrës për Punë Sociale-Drenas.

**Neni 2**

**Shpallja e Interesit të përgjithshëm publik** dhe destinimi i këtyre ngastrave bëhet për shkak të nevojës për sigurimin e një hapësire të përshtatshme dhe funksionale për Qendrën për Punë Sociale duke marrë parasysh se objekti aktual i Qendrës nuk i ploteson kushtet hapësinore, funksionale dhe infrastrukturore të nevojshme për zhvillimin e punës në mënyrë efikase, të sigurt dhe dinjitoze. Për këtë arsye, destinimi i këtyre ngastrave kadastrale është i nevojshëm për funksionimin më të mirë të Qendrës dhe për përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

**Neni 3**

Ngastrat kadastrale që do të shpallen me interes të përgjithshëm kanë këto karakteristika: Njësia kadastrale 391-5 në sipërfaqe prej 2000 m<sup>2</sup> dhe pjesë e parcelës 381-1 me sipërfaqe prej 1220 m<sup>2</sup> Zona kadastrale Gillogoc, të cilat janë në pronësi të Komunës Drenas/Gillogoc.

**Neni 4**

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë përkatëse që konform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme.




## Neni 5

Me këtë vendim do të njoftohen organet kompetente të Komunës së Drenasit/Gllogocit.

## Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPI-së.

 Kryetari i Komunës  
  
Ramiz Lladrovci

## ARSYETIM

Qendra për Punë Sociale ushtron veprimtari me rëndësi të veçantë për komunitetin në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare. Objekti aktual i Qendrës nuk i plotëson kushtet e nevojshme hapësinore dhe funksionale për zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve në mënyrë adekuate, andaj duke u bazuar në nenin 17, paragrafi 1, nënparagrafi k) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe në Ligjin Nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare, Komuna ka përgjegjësi për ofrimin e shërbimeve të mirëqenies sociale.

Meqenëse objekti aktual i Qendrës për Punë Sociale – Drenas nuk i plotëson kushtet e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë dhe ofrimin e shërbimeve sociale, destinimi i ngastrës kadastrale 391-5 në sipërfaqe prej 2000 m<sup>2</sup> dhe pjesë e parcelës 381-1 në sipërfaqe prej 1220 m<sup>2</sup> në Zonën Kadastrale Gllogoc paraqet nevojë dhe interes të përgjithshëm për Komunën e Drenasit.

Për këtë arsye, propozohet miratimi i këtij Propozim-Vendimi, me qëllim të krijimit të kushteve të përshtatshme për funksionimin e Qendrës dhe ofrimin cilësor të shërbimeve për qytetarët.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
**Komuna e Drenasit**  
Zyra e Kryetarit



Nr 01-400/01-34729 dt. 12/08/2026

Në bazë të nenit 58, pika h, neni 17, pika k, i Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72.2 pika a të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 pika d të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"), Ligjit Nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare si dhe kërkesës nga Udhëheqësja e Qendrës për Punë Sociale e dt:18.08.2026 , Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e ardhshme të aprovoi këtë:

**Propozim Vendim**

**Për shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të parcelës nr. 391-5 dhe pjesë e parcelës 381-1 ZK Drenas, për nevojat e Qendrës për Punë Sociale-Drenas.**

**Neni 1**

**Të MIRATOHET** Propozim -Vendim që të shpallet me interes të përgjithshëm ngastra kadastrale 391-5 dhe pjesë e ngastrës 381-1 ZK Drenas, dhe të njëjtat do të shfrytëzohen për nevoja të Qendrës për Punë Sociale-Drenas.

**Neni 2**

**Shpallja e Interesit të përgjithshëm publik** dhe destinimi i këtyre ngastrave bëhet për shkak të nevojës për sigurimin e një hapësire të përshtatshme dhe funksionale për Qendrën për Punë Sociale duke marrë parasysh se objekti aktual i Qendrës nuk i ploteson kushtet hapësinore, funksionale dhe infrastrukturore të nevojshme për zhvillimin e punës në mënyrë efikase, të sigurt dhe dinjitoze. Për këtë arsye, destinimi i këtyre ngastrave kadastrale është i nevojshëm për funksionimin më të mirë të Qendrës dhe për përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

**Neni 3**

Ngastrat kadastrale që do të shpallen me interes të përgjithshëm kanë këto karakteristika: Njësia kadastrale 391-5 në sipërfaqe prej 2000 m<sup>2</sup> dhe pjesë e parcelës 381-1 me sipërfaqe prej 1220 m<sup>2</sup> Zona kadastrale Gllogoc, të cilat janë në pronësi të Komunës Drenas/Gllogoc.

**Neni 4**

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë përkatëse që konform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministrastvo Životne Dredine, Prostornong Planianja i  
Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVES/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Glogoc

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice : Pjesë e parcelës 00381-1

Zona kadastrale / Katastarska zona: Glogoc

Numri i lëndës / Broj predmeta: \_\_\_\_\_

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : Parcelë

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 1000

Lista e koordinatave, kodi dhe përshkrimi i tyre / Lista koordinata, kod i njësitit



Udhëheqës i Sektorit të Gjeodezisë: Safet Hoxha

Nënshkrimi / Potpis: \_\_\_\_\_

Data e qelqimit / Datum snimanja: 18.08.2026





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosova  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministrastvo Životne Dredine, Prostornong Planianja i  
Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Glllogoc

Nr. i njësisë kadastrale / Dr. katastarske jedinice : Pjesë e parcelës  
00381-1

Zona kadastrale / Katastarska zona: Glllogoc

Numri i lëndës / Broj predmeta: \_\_\_\_\_

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : Parcelë

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 1000

Lista e koordinatave, kodit dhe përshkrimit të tyre / Lista koordinata, kod i njihov opis



Udhëheqës i Sektorit të Gjendjes: Safet Hoxha

Nënshtetues / Potpis: \_\_\_\_\_

Data e rrethimit / Datum snimanja: 18.08.2026







Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja /

Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70315016-00391-5

|                                                                                          |                                |
|------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:                                    | 07-463/2026                    |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:        | 18.08.2026 - 09:08             |
| Komuna / Opština / Municipality:                                                         | GLLOGOC / GLOGOVAC / GLLOGOC   |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:                                     | Gillogoc / Glogovac / Gillogoc |
| Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | GLLOGOC / GLOGOVAC / GLLOGOC   |

| Numri i njësise kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësise<br>Vrsta jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type                        | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>(m²) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------|---------------------------|----------------------------------------|----------------------------------|---------------------------------------------------|----------------------------------|
| P-70315016-00391-5                                                        | PARCELË / PARCELA<br>/ PARCEL                  | Pronë shtetërore /<br>Državljena<br>Imovina /<br>Socially owned<br>Land |                           | 2000                                   | 31/6-RDP                         |                                                   |                                  |

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur<br>Mesto zvano<br>Called place | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Emri i rrugës<br>Naziv ulice<br>Street name | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|------------------------------------------------|---------------------------------------------|---------------------------------------------|---------------------------------------------------|----------------------------------|
| FSHAT-SEISHT                                   | 0                                           |                                             |                                                   |                                  |



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosova**  
**Qeveria -Vlada-Government**

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministrastvo Životne Dredine, Prostornog Planiranja i  
Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Gillogoc

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice : Pjesë e parcelës 00381-1


Zona kadastrale / Katastarska zona: Gillogoc

Numri i lëndës / Broj predmeta: \_\_\_\_\_

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : Parcelë

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 1000

Lista e koordinatave, kodit dhe përshkrimit të tyre / Lista koordinata, kod i njihov opis



Udhëheqës i Sektorit të Gjeodezisë: Safet Hoxha

Nënshtetësi / Poimje: \_\_\_\_\_

Data e rrethimit / Datum shumanja: 18.08.2026





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR  
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA  
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

**KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN**

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : GLLOGOC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Gllogoc

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type            | Sipërfaqja/Povšina/Area m² |
|----------------------|----------------------------|----------------------------|
| P-70315016-00381-1   | Parcelë / Parcela / Parcel | 4510                       |



Shkalla/Razmera/Scale: 1:676

Punoi/Obradio/Created: Safet Hoxha

Nënshkrimi/Potpis/Signature: \_\_\_\_\_

Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 18.08.2026

Koha/ Vreme/ Time: 09:01:31



Republika e Kosovës  
Republica Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja /  
Ministry of Environment and Spatial Planning  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70315016-00381-1

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 07-463/2026  
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 18.08.2026 - 08:57  
Komuna / Opština / Municipality: GLLOGOC / GLOGOVAC / GLLOGOC  
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Gillogoc / Glogovac / Gillogoc  
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: GLLOGOC / GLOGOVAC / GLLOGOC

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type                        | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>(m <sup>2</sup> ) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------|---------------------------|-----------------------------------------------------|----------------------------------|---------------------------------------------------|----------------------------------|
| P-70315016-00381-1                                                        | PARCELE / PARCELA<br>/ PARCEL                  | Pronë shoqërore /<br>Društvena /<br>Imovina /<br>Socially owned<br>Land | Urban                     | 4510                                                | 0033-84                          |                                                   | 03.02.2020                       |

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur<br>Mesto zvano<br>Called place | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Emri i rrugës<br>Naziv ulice<br>Street name | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|------------------------------------------------|---------------------------------------------|---------------------------------------------|---------------------------------------------------|----------------------------------|
| FSHAT-OBORISHTE                                | 0                                           |                                             |                                                   | 03.02.2020                       |



## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>(m <sup>2</sup> )<br>(m <sup>2</sup> ) |
|-------------------------|------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------|
| 1                       | Tokë Ndërtimore/Gradjevinsko zemljište/Construction land                           | Oborr/Dvoriste/BackYard                                                            |                                                       | 4510                                                                     |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights                                        | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivalište<br>Resident | Kodi postar<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojednostoli adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|----------------------------------------------------------------------|---------------------|---------------------------------------|----------------------------------------|---------------------------------------------|---------------------------------------------------------------|----------------------------------------------|-----------------------------------|----------------------------------|
| Poseëdim individual /<br>Individualna Dizevina /<br>Single possessor | Komuna e Glllogocit | 600316708                             | GILLOGOC /<br>GILGOVAC /<br>GILLOGOC / |                                             | FEHMI DHE XHEVË<br>LLADROVCI                                  | 1/1                                          | 0033-84                           |                                  |





Republika e Kosovës  
Komuna e Drenasit  
Drejtoria për Bujqësi dhe  
Zhvillim Rural



|        |                                                                        |
|--------|------------------------------------------------------------------------|
| Datë:  | 10.08.2026                                                             |
| Për:   | MBPZIR – Departamenti i Prodhimtarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve          |
| Nga:   | Drejtori i Drejtoratit për Bujqësisë dhe Zhvillim Rural, Donika Prenku |
| Lënda: | Raport rreth korrje-shirjeve në territorin e komunës së Drenasit 2026  |

## Raport

Me Aktvendimin e Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, me nr. protokoli 01 Nr. 020/04-25811, datë 02.07.2026, është përcaktuar çmimi orientues për shërbimet e korrje-shirjeve në vlerë prej 140.00 € për hektar, çmim i dakorduar ndërmjet fermerëve dhe operatorëve të autokombajnave.

Sipas të dhënave të Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, në territorin e Komunës së Drenasit gjatë vitit 2026 me drithëra të bardha janë mbjellë gjithësej 3,235.00 hektarë.

Para fillimit të fushatës së korrje-shirjeve, Drejtoria ka ndërmarrë të gjitha përgatitjet e nevojshme organizative dhe teknike. Janë inspektuar dhe verifikuar autokombajnat që kanë marrë pjesë në fushatë, ndërsa numri i tyre ka qenë rreth 40 autokombajna.

Fushata e korrje-shirjeve ka filluar më 04.07.2026 dhe ka përfunduar më 06.08.2026, me kohëzgjatje prej 29 ditësh.

Bazuar në të dhënat e grumbulluara në terren, rendimenti mesatar i grurit ka qenë 5,100 kg/ha, duke shënuar rezultate më të mira krahasuar me vitet paraprake. Kushtet klimatike gjatë sezonit kanë ndikuar pozitivisht në zhvillimin e kulturave bujqësore dhe në rritjen e rendimentit.

### Rendimenti mesatar sipas kulturave paraqitet në tabelën vijuese.

| Kultura | Sipërfaqet e mbjellura | Rendimenti mesatar kg |
|---------|------------------------|-----------------------|
| Grurë   | 2970                   | 5100                  |
| Elb     | 40                     | 4300                  |
| Thekër  | 25                     | 4400                  |
| Tërshër | 90                     | 3500                  |



Gjatë realizimit të fushatës së korrje-shirjeve janë evidentuar disa sfida, kryesisht të lidhura me përdorimin e autokombajnave me vjetërsi të madhe. Në disa raste janë vërejtur humbje të sasisë së grurit si rezultat i konsumimit të hederit dhe mekanizmit të shirjes.

Gjithashtu, numri i vogël i pikave grumbulluese në territorin e Komunës së Drenasit ka bërë që një pjesë e fermerëve të dorëzojnë prodhimin jashtë komunës, duke rritur kostot e transportit dhe kohën e dorëzimit.

Gjatë gjithë periudhës së korrje-shirjeve, Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, në bashkëpunim me komisionin komunal dhe administratorët e fshatrave, ka zhvilluar aktivitete informuese dhe ndërgjegjësuere për ndalimin e djegies së hamulloreve.

Falë këtyre aktiviteteve dhe bashkëpunimit me qytetarët, gjatë këtij sezoni nuk janë evidentuar raste të djegieve masive të hamulloreve në territorin e Komunës së Drenasit.

### **Rekomandim:**


Për përmirësimin e mëtejshëm të organizimit dhe efikasitetit të fushatës së korrje-shirjeve rekomandohen:

- Të mbështetet modernizimi i mekanizmit bujqësor përmes programeve të investimeve dhe subvencionimit të autokombajnave të reja.
- Të organizohen trajnime periodike për operatorët e autokombajnave lidhur me standardet teknike, zvogëlimin e humbjeve gjatë korrjes dhe rritjen e efikasitetit të punës.
- Të rritet numri i pikave grumbulluese dhe kapacitetet për pranimin e grurit në territorin e Komunës së Drenasit.
- Të vazhdojnë aktivitetet vetëdijësuese për ndalimin e djegies së hamulloreve dhe mbrojtjen e mjedisit.
- Të vazhdojë bashkëpunimi ndër-institucional ndërmjet Komunës, Ministrisë së Bujqësisë dhe shoqatave të fermerëve për përmirësimin e organizimit të fushatës së korrje-shirjeve.

**Përfundim:** Bazuar në të dhënat e mbledhura nga komisioni komunal për korrje-shirje, vlerësohet se fushata e korrje-shirjeve në territorin e Komunës së Drenasit është realizuar me sukses, brenda afateve të planifikuara dhe pa probleme madhore organizative. Rendimentet e arritura paraqesin një rezultat të kënaqshëm dhe më të lartë krahasuar me vitet paraprake, duke reflektuar angazhimin e fermerëve, operatorëve të autokombajnave dhe institucioneve përgjegjëse.

**Anëtarët e komisionit komunal për korrje- shirje**

1. Donika Prenku – Kryetar – ( Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural )
2. Ilir Berisha – Anëtar ( Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural )
3. Mensur Gllareva – Anëtar ( Drejtorati i Inspeksionit )
4. Sejdi Kozhani ( Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emergjente )
5. Anita Avdullahu- Dvorani ( Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural )



**tu dërgohet:**

- Zyrës së Kryetarit;
- DBZHR-së
- Anëtareve të komisionit.

---

**DRENAS-GUSHT, 2026**

---